POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Pensionistët në lindje të Gjermanisë kanë më pak pasuri dhe të ardhura se ata në perëndim

2 'Dy gosti', filmi me lejlekun punëtor do të restaurohet

3 Kriza politike në Kosovë, Albin Kurti bën një hap pas! Vetëvendosja: Të dielën mblidhet seanca konstituive, do të votojmë Vlora Çitakun dhe Kujtim Shalën për nënkryetarë të Kuvendit

4 Nuk ka 'fund' droga e sekuestruar e 'të tmerrshmit të Beratit', gjenden edhe 27 kg kokainë pranë vendit ku u arrestua Lulzim Caka

5 I vuri 300 mijë euro 'gjobë' kushëririt duke i kanosur familjen, arrestohet 56-vjeçari në Vorë! I la fishek dhe letër kërcënuese te dera e shtëpisë (EMRI+VIDEO)



Kronikë

# Ishte i parkuar në oborrin e shtëpisë, mbi 30 plumba drejt një makine në Mat! Gjendet i djegur automjeti i autorëve (VIDEO)

*Për momentin nuk raportohet për persona të plagosur apo viktima.*

I parkuar në oborrin e shtëpisë, mbi 30 plumba drejt një makine në Ma
Report TV

Watch on

Redaksia
13 Shtator, 10:17 | **Përditesimi: 13 Shtator, 10:23**

Share Post

Një automjet është gjetur i djegur rreth orës 01:00 të mëngjesit të sotëm në njësinë administrative Urak, në Bashkinë Mat.

Dyshohet se automjeti i përket autorëve që kanë qëlluar me armë zjarri ndaj një makine tjetër, ku mësohet se janë qëlluar mbi 30 plumba.

Për momentin nuk raportohet për persona të plagosur apo viktima.



LEXO EDHE:
**SPECIALE/ Pas 30 vitesh në emigrim, familja nga Dibra rikthehet në vendlindje për të sfiduar rrjedhën e Drinit të Zi (VIDEO)**

Policia ka mbërritur në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave, identifikimin e autorëve.

**Njoftimi i policisë:**

*Më datë 12.09.2026, rreth orës 23:10, në fshatin Urakë, Njësia Administrative Rukaj, Bashkia Mat, nga persona ende të paidentifikuar është qëlluar me armë zjarri në drejtim të automjetit tip "Audi", në pronësi të shtetases S. Ll. (bashkëshortja e shtetasit A. Ll.), i parkuar në oborrin e banesës.*

*Nga të shtënat janë shkaktuar dëmtime materiale vetëm në automjetin tip "Audi".*

*Shërbimet e Policisë, me marrjen e njoftimit, shkuan menjëherë në vendngjarje dhe, në bashkëpunim me DVP Dibër, ngritën pika kontrolli.*

*Ndërkohë, në vendngjarje shkoi grupi hetimor.*

*Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit të territorit, rreth 2 kilometra larg nga vendi i ngjarjes, në aksin rrugor Rrëshen-Burrel, kanë konstatuar të djegur një automjet tip "Golf V". Gjatë këqyrjes së automjetit, në brendësi të tij janë gjetur dy armë zjarri kallashnikov, të djegura pjesërisht, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.*

*Nga verifikimet e kryera rezulton se automjeti tip "Golf", i konstatuar i djegur, ishte shpallur në kërkim nga DVP Elbasan më datë 31.07.2025, pasi kishte bërë kallëzim pronari i tij, shtetasi K. R., banues në Përrenjas, se i kishin vjedhur këtë automjet.*

*Shërbimet e Policisë po vijojnë kontrollet në zonën ku mund të kenë lëvizur autorët e dyshuar dhe po bashkëpunohet me DVP Tiranë, Lezhë e Kukës.*

*Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, vijon intensivisht veprimet me qëllim zbardhjen e rrethanave, sigurimin e provave që do të çojnë në identifikimin dhe kapjen e autorëve.*

*Lajm në përditësim...*

P.J/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Diber Mat te shtena me arme

Sa e vlerësoni këtë artikull?

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 7 Shtator, 07:56
**Ngërçi për pagat e drejtësisë, kujt i jepni të drejtë?**

Qeverisë | Magjistratëve | Nuk e di

## Lajme të tjera



Zbulimi arkeologjik në Strikçan të Bulqizës, finalist për Çmimin Ndërkombëtar "Palmyra"
11 Shtator, 22:05



Para nisjes së vitit shkollor, Hita shpalos prioritetet e Policisë në Tiranë, Korçë e Dibër: Luftë krimit dhe drogës, rrisim kontrollet pranë shkollave!
11 Shtator, 17:07



7 vatra aktive zjarri në të gjithë vendin, 10 nën monitorim! Riaktivizohen flakët në Mallakastër, ndërhyhet me helikopter
10 Shtator, 10:29



Zjarre në Pukë, Shkodër dhe Lezhë, digjen qindra ha pyje! Droni 'kap' 2 piromanë, ministri Lamallari: Ndëshkim për shkelësit (VIDEO)
7 Shtator, 10:38



SPECIALE/ Fshati që u vetëmbrojt me ligje pleqnie: Si po e kthen turizmi rininë në Radomirë
Benet Beqiri
6 Shtator, 09:49



Zjarret/ Në Kalivaç të Lezhës digjen disa banesa, raportohet edhe për shpërthime! Evakuohen banorët! Problematike edhe vatrat në qarkun Dibër (VIDEO)
3 Shtator, 09:59



Zjarret/ 4 vatra aktive në Shqipëri, 100 hektarë pyje të djegura në Lundre të Matit! 183 forca në terren për shuarjen e flakëve
2 Shtator, 09:58



Zjarret në Ulëz të Dibrës vënë në rrezik shtëpitë, pritet evakuimi i banorëve të zonës
1 Shtator, 17:18



Zjarret në vend, 4 vatra mbeten aktive! Vijon beteja me flakët në Dajt, Bulqizë, Mat dhe Skrapar, 254 forca dhe 2 helikopterë në aksion
1 Shtator, 09:53



Dibër/ E mitura u mbyt nga shkarkimet e HEC-it në Drinin e Zi, Prefekti: Do t'i kërkojmë Maqedonisë së Veriut të vendosë orare për hapjen e portave
Mahir Jangulli
31 Gusht, 16:48



Të dehur në timon dhe parakalime të gabuara, Rrugorja e Dibrës bën bilancin: 1760 shkelje të qarkullimit në 2 javë (VIDEO)
31 Gusht, 14:42



Këshilli Bashkiak i Klosit kundër bashkimit me Matin! 12 këshilltarë votojnë kundër, 8 të PD e PS bojkotojnë (VIDEO)
Mahir Jangulli
31 Gusht, 13:09

Lajmi i fundit



'Dy gosti', filmi me lejlekun punëtor do të restaurohet
13 Shtator, 13:43



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit



'Dy gosti', filmi me lejlekun punëtor do të restaurohet

13 Shtator, 13:43